



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 458 Prot.

Tiranë, më 26. 02. 2026

V E N D I M

Nr. 43, datë 26. 02. 2026

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 219 Regj., datë 02.10.2025, të paraqitur nga S. F. dhe L. F., kundër Shoqërisë së Transportit “Lu-Na”¹ sh.p.k., me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjektet ankues në mes të tjerash informuan se: “Më datë 07.09.2025 kam marrë në orën 08:00, autobusin me targë AA ... EA, në Terminalin e Tiranës, për të udhëtuar drejt qytetit të Laçit.

Autobusi nuk kishte faturino dhe pagesa e biletës bëhej te shoferi, në momentin e zbritjes nga autobusi. Kur arritëm në Laç, i paraqitëm shoferit librezat e verbërisë dhe i thamë që të verbërit duhet të udhëtojnë me gjysmë bilete, ai tha që në autobusin tim askush nuk mund të udhëtojë me 50 % të biletës, sepse unë nuk e njoh ligjin.

¹ Me Nipt: K31412087P

² Referuar Librezës së Verbërisë nr., të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, S. F. është i verbër Grupi i I-të. Ndërsa referuar Dëshmisë Nr., datë 01.04.2025, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, L. F. është Invalide Pune e shkallës së II-të.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

I kërkuam të na pajisi me biletë përndryshe nuk do të paguanim ose do të telefononim policinë. Fillimisht nuk donte të na jepte biletat por pasi nxorëm telefonat për të lajmëruar policinë, atëherë shoferi u detyrua të na jepte biletat dhe ne bëmë pagesën e plotë të tyre, prej 500 lekë për person.

Në autobus nuk kishte tabela për personat me aftësi të kufizuara, e cila ka qenë e negociuar me kompaninë e transportit Laç në zyrat e Komisionerit”.

Subjektet ankues, kërkuan nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tyre për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë së Transportit “Lu-Na” sh.p.k. dhe eliminimin e pasojave të ardhura si rezultat i diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të shprehur shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, atë të aftësisë së kufizuar. Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të LMD. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

f) lehtësi për transport ose udhëtim;”.

1. Në kushtet kur, pala ankuese nuk kishte mundur të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Tiranë-Laç-Tiranë, por vetëm targën e autobusit AA ... EA, me të cilin kishin udhëtuar në datën 07.09.2025, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet shkresës nr. 1373/2 prot., datë 07.10.2025, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim.

Në përgjigje sa më sipër, përmes shkresës⁴ nr. 19702/1 prot., datë 10.10.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve Tiranë - Laç - Tiranë dhe Laç - Tiranë – Laç janë të miratuara me Udhëzimin Nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar dhe lëshimi i licencës dhe certifikatave për operimin në këto linja kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Nga verifikimi në sistemin elektronik e Transportit, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë - Laç - Tiranë, është licencuar shoqëria “Lu-Na” sh.p.k., me NIPT K.....P, mbajtës i licencës nr. 7, lëshuar me datë 12.05.2022, me afat vlefshmërie deri me datë 11.05.2027, ndërsa në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Laç - Tiranë - Laç është licencuar shoqëria L.....- 1” sh.p.k., me NIPT L..... D, mbajtës i licencës nr. 229, lëshuar me datë 12.09.2022, me afat vlefshmërie deri më datë 11.09.2027.

Përsa i përket kërkesës për informacion për mjetin me targë AA EA, rezulton në pronësi të subjektit “Lu-Na” sh.p.k., i cili është pajisur me certifikatën e operimit nr. 31, lëshuar me datë 23.05.2025, me afat vlefshmërie deri më datë 23.05.2026, në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Tiranë - Laç - Tiranë.

Sqarojmë se, në zbatim të VKM-së nr. 465, datë 26.07.2018 “Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre”, Task-Forca e Transportit Rrugor është organ i specializuar në varësi të MIE, me funksion kontrollin në rrugë dhe verifikimin e zbatimit të veprimtarisë së këtyre subjekteve konform legjislacionit në fuqi...”.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1373/3 prot., datë 13.10.2025

Pasi ankesa u plotësua me informacionin e nevojshëm në lidhje me identifikimin e subjektit, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të LMD, Komisioneri ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

2. Pas plotësimit nga pikëpamja formale, të kërkesave të parashikuara nga neni 33/3 i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri filloi procedurat përkatëse të shqyrtimit të ankesës, ku me shkresën Nr. 1373/4 prot., datë 16.10.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shoqëria “Lu-Na” shpk, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues, si dhe ka kërkuar informacionin si më poshtë:

- Informacion nga ana e Shoqërisë “Lu-Na” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Lu-Na” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”*.
- Kopje të licencës të Shoqërisë “Lu-Na” sh.p.k.
- Kopje të certifikatës për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse të mjetit me targa: AA EA.

Në përgjigje sa më sipërcituar, përmes shkresës⁵ nr. 347 prot., datë 21.10.2025, Shoqëria “Lu-Na” shpk, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Shoqëria “Lu-Na” shpk, ushtron aktivitetin e saj në fushën e transportit të udhëtarëve, në përputhje me Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, aktet nënligjore përkatëse, si dhe me rregulloret e brendshme të miratuara që garantojnë respektimin e të drejtave të pasagjerëve dhe punonjësve që nga viti 2004.*

Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, si dhe sqarimin e fakteve dhe rrethanave reale që lidhen me rastin konkret, në kuadër të hetimit administrativ që po zhvillon Komisioneri, ju parashtrojmë si më poshtë:

Së pari:

Pretendimet e ngritura nga ankuesit S. F. dhe L. F., nuk qëndrojnë pasi janë në shtrembërim të fakteve dhe rrethanave, bazuar kjo në verifikimet e kryera.

Pas vënies në dijeni nga ana juaj lidhur me pretendimet e tyre, ne si shoqëri kemi marrë informacione të detajuara nga shoferi i mjetit të “Lu-Na” sh.p.k., T. Ll. dhe kemi kërkuar një deklarament me përgjegjësi të plotë ligjore rreth ngjarjes së datës 07.09.2025 dhe konkretisht ai deklaroi se: “Sipas planizimit të Kompanisë Lu-Na shpk, në datën 07.09.2025, në orën 08.00, jam nisur nga terminali i autobusave Tirana -Veri me destinacion qytetin e Laçit. Kur arritëm në

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1181/2 prot., datë 16.09.2024.

qytetin e Laçit në stacionin e autobuzave, midis pasagjerëve po zbriste edhe një çift pasagjerësh, një grua me një person të verbër në dukje, ku zonja më jep mua lekët për veten e saj dhe për pasagjerin e verbër më thotë: “Ky është invalid dhe nuk paguan biletë”, në këtë moment duke qenë se ishte rasti i parë i hasur me të tilla pretendime, dhe unë doja të saktësoja se invalidët udhëtojnë me gjysmën e vlerës së biletës apo falas (pasi kam qenë informuar nga kompania për udhëtimet e invalidëve falas apo me gjysmë çmimi), unë i kërkoja të prisnin një minutë sa të kontrolloja certifikatën e mjetit autobus dhe pasi lexoj te certifikata se: “Të verbërit e shoqëruesit e tyre, që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”, i them zonjës që: “Eja ke të drejtë dhe merri lekët që më dhe për veten tënde se e keni falas nga firma”. Në këtë moment gruaja më thotë që: “...tani unë nuk i dua lekët dhe shihemi në gjyq...”. Dëshmitar që e dëgjuan të gjithë këtë bisedë janë: R. L., B. G. dhe Z. L., që janë punonjës këtu te agjencia e autobuzave në Laç.

Më pas, gruaja i bën foto targës dhe autobuzit dhe u largua nga unë. Nga ana ime nuk është pajisur me biletë, për shkak se biletat fizike, nuk po përdoren, pasi jemi në pritje të vendosjes të sistemit elektronik për prerjen dhe fiskalizim të biletave të transportit ndërqytetës nga administrata Tatimore, problem ky që dihet dhe nga Tatimet, ku në përfundim të udhëtimit unë raportoje te zyra e kompanisë për numrin e pasagjerëve dhe kompania pret online kupona tatimore nga zyra.

Gjatë kryerjes së detyrës sime nuk kam ushtruar dhe as nuk kam qenë pjesë e ndonjë veprimi apo sjelljeje diskriminuese ndaj asnjë pasagjeri tjetër, për asnjë shkak që lidhet me gjininë, racën, përkatësinë etnike, gjuhën, bindjet politike apo fetare, moshën, aftësinë e kufizuar, apo ndonjë shkak tjetër të ndaluar me ligj”.

Pra fakti administrativ i paraqitur në ankesë nga ankuesja nuk qëndron, bazuar në deklaratat e shoferit T. Ll., të firmosur dhe nga tre dëshmitarët e pranishëm.

Së dyti:

- a) Veprimi i shoferit të Kompanisë “Lu-Na” shpk, objekt i ankesës, edhe pse jo me dashje, nuk vjen në kundërshtim me pikën 1, germën “c” të nenit 20 të ligjit nr. 10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pasi ankuesi e ka përfutur shërbimin e transportit nga Kompania Lu-Na shpk, dhe nuk është refuzuar nga shoferi që të mos i merrte në autobus, por përkundrazi, shoferi menjëherë sapo është vënë në dijeni të faktit, ka kërkuar ti kthej lekët e biletës ankueses, duke i dhënë kësaj mundësinë që të përfitojë nga skema e mbrojtjes shoqërore për shkak të aftësisë së kufizuar, sipas germës “c” të pikës nr. 1 të nenit 20 të ligjit nr. 10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e cila ka refuzuar vetë këtë përfitim duke i thënë shoferit që nuk i dua lekët dhe shihemi në Gjyq.
- b) Asnjë nga veprimet e pretenduara nuk përbën diskriminim sipas nenit 1, pika 2, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pasi shoqëria nuk ka ushtruar, toleruar apo lejuar sjellje që synojnë ose rezultojnë në trajtim më pak të favorshëm për ndonjë person, për shkak të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, bindjeve politike, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar apo ndonjë shkak tjetër të ndaluar me ligj.

Shoqëria “Lu-Na” shpk ka një rregullore të brendshme pune dhe udhëzime për stafin e saj që përcaktojnë qartë ndalimin e çdo forme diskriminimi apo trajtimi të pabarabarte, si ndaj punonjësve, ashtu edhe ndaj pasagjerëve me të cilën, njihen të gjithë punonjësit e saj.

Së treti:

Në rastin konkret, nga verifikimet e brendshme të kryera nga administrata e shoqërisë dhe deklaratimet e stafit përkatës (përfshirë edhe shoferin T. Ll.), nuk rezulton asnjë sjellje apo veprim i karakterit diskriminues ndaj ankuesit, por përkundrazi, ankuesja nuk ka dëshiruar që situata të zgjidhej me mirëkuptim mes palëve, në atë moment kur është konstatuar fakti, duke mos pranuar kthimin e parave të biletës.

Shoferi T. Ll. ka ndërmarrë të gjitha veprimet nga ana e tij, për ti rikthyer paratë dhe në këtë mënyrë udhëtimi i tyre do të ishte falas në përputhje me kuadrin rregullator, por L. F. nuk ka pranuar dhe përkundrazi e ka kërcënuar se ndaj tij do ndërmarrë veprime ligjore që ai të sanksionohet.

Shoqëria ka bashkëpunuar dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë plotësisht me institucionin e Komisionerit, duke vënë në dispozicion çdo informacion shtesë që kërkohet për zbardhjen e rastit dhe shmangien e situatave të ngjashme në të ardhmen.

Në përfundim, sa më sipër, shoqëria “Lu-Na” shpk, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që:

- 1. Të konstatojë mungesën e elementëve të diskriminimit në veprimet e punonjësit të shoqërisë Lu-Na shpk, T. Ll.*
- 2. Të pushojë hetimin administrativ ndaj subjektit “Lu-Na” shpk, për mungesë të faktit administrativ dhe ngjarja nuk përbën elemente të shkeljes së dispozitave ligjore të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.*
- 3. Të marrë në konsideratë bashkëpunimin korrekt dhe transparent të shoqërisë gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ.”*

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar Shoqëria “Lu-Na” shpk, vuri në dispozicion të Komisionerit:

- Kopje të licencës së Shoqërisë “Lu-Na” shpk;
- Kopje të Certifikatës për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse të mjetit me targa AA ... EA;
- Deklaratë e shoferit T. Ll. e firmosur dhe nga dëshmitarët R. L., B. G. dhe Z. L.
- Informacion mbi shërbimet e transportit të personave me aftësi të kufizuara të ofruar nga kompania “Lu-Na” shpk.

- 3. Për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 1373/5 prot., datë 27.11.2025 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri ftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 03.12.2025.**

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm ankuesja L. F. e autorizuar nga bashkëshorti i saj, S. F. për ta përfaqësuar në seancë, përmes kërkesës datë 03.12.2025.

Gjatë seancës dëgjimore pala ankuese i qëndroi pretendimeve për diskriminim që ka parashtruar në ankesë, ndërsa nga ana e Shoqërisë “Lu-Na” shpk nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ankuesi, S. F., i datëlindjes, është person me aftësi të kufizuara në shikim, fakt që rezulton i provuar nga Librezat e Verbërisë nr., lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, duke qënë në këtë mënyrë përfitues i ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar. Ndërsa bashkëshortja e tij, L. F., është Invalide Pune e shkallës së II-të, fakt i provuar nga Dëshmia Nr., datë 01.04.2025, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë.

Ankuesit deklarojnë se në datë 07.09.2025, kanë udhëtuar nga Tirana për në Laç. Kanë hipur në autobusin me targë AA EA, rreth orës 08:00 dhe autobusi nuk kishte faturino dhe lekët i merrte shoferi në momentin e zbritjes. Kur arritën në Laç, i kanë paraqitur shoferit librezat e verbërisë dhe i kanë thënë që të verbërit duhet të udhëtojnë me gjysmë bilete, por ai i ka thënë që në autobusin e tij askush nuk mund të udhëtojë me 50 % të biletës, sepse nuk e njeh ligjin dhe duhet të paguajnë biletën e plotë.

Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit të ankesës se, linja e transportit në të cilën ka udhëtuar ankuesi është një linjë e transportit ndërqytetës që lidh qytetin e Tiranës me Laçin. Në bazë të informacionit të administruar rezultoi se, autobuzi me targa AA EA, me të cilin ankuesit kanë udhëtuar, është i pajisur me certifikatë “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse” nr. 31, lëshuar në datë 23.05.2025, me afat vlefshmërie deri në datë 23.05.2026 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Tiranë-Laç-Tiranë, mjet i certifikuar për operim në emër të Shoqërisë Lu-Na sh.p.k, me NIPT K.....P.

Shoqëria Lu-Na sh.p.k, ofron shërbimin e transportit në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Laç-Tiranë bazuar në licencën me nr. 7, lëshuar në datë 12.05.2022, nga DPSHTRR, me afat vlefshmërie deri në datë 11.05.2027.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit ankuesit pretendojnë se janë diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë Lu-Na sh.p.k, përmes mosnjohjes të së drejtës për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas, sipas lehtësirave të përcaktuara për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Për të vlerësuar pretendimet e parashtruara nga palët ankuese, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin urban ndërqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar/të verbër.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi⁶ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas⁷ dhe (3) transport ndërqytetas. Transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit, i cili nëpërmjet Urdhrit nr. 318, datë 02.11.2020, “*Për delegim kompetence*”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka autorizuar Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), si organin kompetent për lëshimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetas, mbi bazën e rrjetit të linjave të miratuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për transportin rrugor. Në rastin objekt shqyrtimi, jemi përpara rastit të transportit ndërqytetas.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime, lidhur me përfitimin e transportit për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizë Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*”, i ndryshuar. Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “*Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat*”.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”*”. Aktualisht, ky nen parashikon: “*Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”.

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban falas dhe transport interurban⁸/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende. Në vendimmarrjet e mëparshme të Komisionerit⁹ lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*”, i ndryshuar.

⁶ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

⁷ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

⁸ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁹ Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: “3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.....10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër bëhet me 0% të tarifave për transportin urban dhe 50% të tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i të verbërit të grupit të parë”.

Legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban ndërqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar në transportin ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)¹⁰ parashikon: “Është e detyrueshme të kryhet perkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”. Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin ligjor specifik.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Sipas këtij udhëzimi, personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4, të udhëzimit, përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

¹⁰ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjet: nr. 8908, datë 6.6.2002, nr. 9096, datë 3.7.2003, nr. 9373, datë 14.4.2005, nr. 9760, datë 21.6.2007, nr. 10137, datë 11.5.2009, nr. 10 302, datë 15.7.2010, nr. 118 /2012, datë 13.12.2012, nr.21/2013, datë 14.2.2013, nr. 37/2014, datë 10.4.2014, nr. 10/2016, datë 11.2.2016.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbrit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016 *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar¹¹, në nenin 14, përcakton: “5. Subjekti është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t’i krijojë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuara përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e licencës dhe, ose certifikatës së autobusit”. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë edhe lidhjet që i bashkëlidhen këtij akti, në të cilat parashikohen dispozita të përgjithshme ku formulohen detyrimet e mbajtësit të licencës që ofron shërbimet e transportit, përfshi edhe transportin ndërqytetës. Konkretisht në Lidhjen 4, të udhëzimit parashikohet:*

“4. Mbajtësi i licences dhe i kësaj certificate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet:

b) Për transportin rrethqytetës dhe ndërqytetës: Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

- “invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50 % të vlerës së biletës”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, të ndryshuar, nr. 8153/96:

- “të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas.

5. Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që i përfitojnë këto lehtësi në transportin në linjat e rregullta, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të ndenjes”.

Parashikimet e mësipërme, gjejnë pasqyrim edhe në certifikatat me të cilat është pajisur Shoqëria Lu-Na sh.p.k për të ushtruar veprimtarinë e transportit në linjën ndërqytetëse Tiranë-Laç-Tiranë. Me marrjen e licensës, Shoqëria Lu-Na sh.p.k ka marrë përsipër dhe ka pranuar edhe këto detyrime në lidhje me ofrimin e shërbimit të transportit në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, bazuar në deklaratimet e palëve rezultoi e provuar se ankuesi ka paguar të plotë çmimin e biletës. Administratori i shoqërisë, përmes shkresës nr. 347 prot., datë 21.10.2025, ka deklaruar përpara Komisionerit se shoferi i punësuar nga Shoqëria nuk ishte i

¹¹ Ndryshuar me: Udhëzimin nr. 3918, datë 18.07.2017, Udhëzimin nr. 438, datë 9.5.2018, Udhëzimin nr. 6, datë 2.11.2020 dhe Udhëzimin nr. 7, datë 03.02.2022.

informuar mbi të drejtën e personave me aftësi ndryshe për përfitimin me gjysën çmimi të vlerës së biletës. Gjithashtu theksoi se, shoferi pasi ishte informuar për lehtësirat në transport që përfitojnë personat me aftësi të kufizuara, kishte kërkuar ti kthente pagesën e biletave subjekteve ankues, por këta të fundit nuk kishin pranuar t'i merrnin.

Në shkresën nr. 347 prot., datë 21.10.2025, Shoqëria Lu-Na, është shprehur që në zbatim të udhëzimeve të licencës, ofron shërbimin për personat me aftësi të kufizuara, por shoferi i mjetit nuk ka dijeni për librezën e verbërisë të paraqitur nga ankuesit. Shoqëria informon se ky ishte rasti i parë që ishte paraqitur një ankesë dhe kanë pasur mirësinë për ta zgjidhur rastin me mirëkuptim.

Sikurse më sipër rezulton, personat me statusin e të verbërit, përfitojnë nga lehtësirat në udhëtim, konform *detyrimit* për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*.

Nga verifikimi i kryer nga ana e Komisionerit në informacionin e disponuar dhe administruar nga ana e tij në kuadër të shqyrtimit të ankesave për diskriminim, nuk rezulton që të ketë ankesa të tjera të së njëjtës natyrë të paraqitura kundër Shoqërisë Lu-Na sh.p.k.

Referuar shkresës nr. 11103/1, datë 13.06.2024, të DPSHTRR¹², theksohet se aktualisht, shoqëritë e transportit ndërqytetës nuk përfitojnë subvencion për transportin e udhëtarëve që duhet të udhëtojnë falas. Kjo është një problematikë e parashtruar vazhdimisht nga shoqatat e transportit ndërqytetës në institucionet qendrore përgjegjëse për nxjerrjen e akteve ligjore/nënligjore përkatëse.

Përfundimisht, duke mbajtur në konsideratë:

- Paqartësitë që ekzistojnë në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, në lidhje me mënyrën e përfitimit të lehtësirave në transport nga ana e personave me aftësi të kufizuara, përfshi personat që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Pa paragjykuar këtu detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër në momentin e pajisjes së saj me licensë;
- Sjelljen e Shoqërisë Lu-Na sh.p.k dhe angazhimit të saj për të mos lejuar përsëritjen në të ardhmen të situatave të së njëjtës natyrë;
- Faktin që ndaj Shoqërisë Lu-Na sh.p.k nuk janë paraqitur ankesa të tjera të së njëjtës natyrë, pra është subjekt për herë të parë;
- Qëllimin parandalues të Komisionerit dhe jo vetëm konstatues dhe ndëshkues.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqëria Lu-Na sh.p.k, nuk duhet të gjendet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2024 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar në dëm të ankuesve, S. F. dhe L. F..

¹² Kjo shkresë është administruar nga Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 110, datë 22.05.2024, për të cilën Komisioneri ka disponuar me Vendimin nr. 238, datë 09.09.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesve S. F. dhe L. F., për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë “Lu-Na” shpk.
2. Rekomandohet Shoqëria “Lu-Na” shpk, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
3. Shoqëria Lu-Na shpk, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)